

CURRICULUM VITAE

AGRON MYZAFER MESI

DITELINDJA: 26 04 1964
VENDLINDJA: Shkodër
VENDBANIMI: Tiranë
ADRESA: Rruga “Medar Shtylla”
TEL: 0694061338

Arsimi

1978-1982 Arsimi i mesëm pranë shkollës artistike “Preng Jakova”, dega e Arteve Figurative, Shkodër.

1983-1987 Arsimi i lartë pranë I.L.A. Tiranë (sot Universiteti i Arteve te Bukura), dega e Arteve Figurative, diplomimi si Piktur-Grafist.

2010-2013 Mastër i Nivelit të Dytë në Dizajn Urban dhe Peisazhi, Universiteti Polis, Tiranë

2013-2018 Shkolla doktorale pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Tiranë. Titulli Doktor i Shkencave

Punësimi

1987-1993 Kinostudio “Shqipëria e Re”(sot Albafilmanimacion). Piktur i filmit vizatimor.

1997-2002 Shkolla e mesme artistike “Preng Jakova”, dega e Arteve Figurative, Shkodër. Mesues i lëndëve: Pikturë, Vizatim, Grafikë.

2002-2009 Shkolla e mesme artistike “Jordan Misja”, dega e Arteve Figurative, Tiranë. Mësues i lëndëve: Pikturë, Vizatim, Grafikë.

2009 dhe në vazhdim Universiteti “POLIS”, Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit, Tiranë. Lektor për lëndët” Vizatim dhe Ilustrim grafik”, “Gjuhë Pamore”, “UrbanArt”.

Kualifikimi

1998 Kualifikim i shkallës së tretë si mesues i profilit të arteve figurative.

1999 Kualifikim në programet kompjuterike - Qendra e Formimit Profesional

2000 Rezidencë për artistët e rinj, programi i lindjes, Cultural City Network, Graz, Austri

2005 Kualifikim i shkallës së dytë si mesues i profilit të arteve figurative.

2010 Dëshmi e gjuhës angleze- Fakulteti i Gjuhëve të huaja. Tiranë.

2015 Dëshmi e gjuhës angleze- University of Cambridge ESOL Examinations, BULATS

Çmimet

1900 Çmimit i tretë në Festivalin e Filmit të Animuar, Tiranë '90, si piktor i filmit vizatimor “Kush e meriton”

2004 Çmimi “Fotografia Art” në Konkursin Ndërkombëtar” Marubi 2004” në G.K.A. Tiranë

2004 Çmimi “Grand Diploma” në Bienalen XI ndërkombëtare” Exhibition of Portrait Drawings and Graphics” në Tuzla, Bosnjë-Hercegovina.

2006 Çmimi “Ilustratori i Vitit” në Panairin “Libri ‘06” në QNK Tiranë

Aktivitetet artistike më kryesore

Pjesëmarrës si krijues në shumë aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare të zhvilluara në fushën e arteve vizive që nga viti 1990 dhe deri sot, brenda dhe jashtë vendit.

Nga më kryesoret mund të vecohen:

Aktiviteti Ndërkombëtar në vitin 1998 “MEDITERRANEA N.1” (Albania/Italia- un commune orizzonte culturale) organizuar nën përkuqdesjen e Presidentit të Republikës së Shqipërisë Rexhep Mejdani dhe të Presidentit të Republikës Italiane Oscar Luigi Scalfaro, nën patronazhin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë dhe të Ministrisë së Kultures, Rinisë dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe të Ministrit Edi Rama. Ekspozitë kuruar nga Gaetano Grillo, përzgjedhje nga ana e tij e 13 artistëve të përfaqësonin artin bashkëkohor në Shqipëri.

Aktiviteti “Art & Maggio” zhvilluar në Bari, Itali në vitin 1999. Ekspozitë e artit kontemporan shqiptar “Albania & Albania”, kuruar nga Eleni Laperi. Përzgjedhje nga ana e saj e 12 artistëve të përfaqësonin artin bashkëkohor shqiptar në Itali.

Aktiviteti i zhvilluar në Bruksel në vitin 2000. Ekspozita ndërkombëtare “Ballkan Art Generator”, iniciuar nga Bashkimi Europian. I përzgjedhur të përfaqësojë Shqipërinë së bashku me artistin tjetër Adrian Paci.

Pjesëmarrës në Bienalen XI Ndërkombëtare ” Exhibition of Portrait Drawings and Graphics” në Tuzla, Bosnjë-Hercegovina, 2004

Pjesëmarrës në Konkursin Ndërkombëtar “Muslim Mulliqi”, G.A. Prishtinë, 2004

Pjesëmarrës në Konkursin Ndërkombëtar “Marubi”, G.K.A. Tiranë, në vitet 2001, 2002, 2003, 2004, 2005.

Pjesëmarrës në Bienalen Ndërkombëtare “TIRANA 3”, Kompleksi “Goldi”, Tiranë, 2005

Pjesëmarrës në Konkursin Ndërkombëtar “ONUFRI ‘12”, G.K.A. Tiranë. 2010.

Aktivite artistike personale

- 1996 Ekspozitë personale pikturë në G.A. Shkodër
- 1998 Ekspozitë personale pikturë në Ulqin, Mali i Zi
- 2000 Ekspozitë personale e fotografisë artistike në G.A. Shkodër
- 2000 Ekspozita personale "Shkodër-Offene Stadt" në Kustlehaus, Graz, Austri

Aktivite artistike kolektive

- 1989 Skenarist dhe piktor i filmit vizatimor "Peshorja", Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë.
- 1990 Piktor i filmit vizatimor "Kush e meriton", Kinostudio "Shqipëria e Re, Tiranë.
(Fitues i cmimit të tretë në festivalin e filmit të animuar, Tiranë '90.)
- 1990 Ekspozita Kombëtare e Rinisë "PRANVERË '90", G.K.A. Tiranë.
- 1991 Ekspozitë pikturë, G.A. Shkodër.
- 1992 Ekspozitë e pikturës shkodrane, G.K.A. Tiranë.
- 1993 Ekspozitë pikturë, Mali i Zi.
- 1994 Ekspozitë pikturë, Galeria T&G Tiranë.
- 1994 Ekspozita "KOLEKTIVNA IZLOZBA SLIKA I SKULPTURA", Bar, Mali i Zi
- 1994 Konkursi Kombëtar "ONUFRI '94", G.K.A. Tiranë.
- 1995 Konkursi Kombëtar "ONUFRI '95", G.K.A. Tiranë.
- 1995 Ekspozitë pikturë, G.A. Shkodër.
- 1997 Konkursi Kombëtar "ONUFRI '97", G.K.A. Tiranë.
- 1998 Ekspozita "KUNSTLER AUS ALBANIEN", Vjenë, Austri
- 1998 Ekspozita Ndërkombëtare "MEDITERRANEA" (piktura bashkëkohore italiane dhe shqiptare), G.K.A. Tiranë.
- 1998 Ekspozita "EDUARD LIR", G.A. Berat.
- 1998 Ekspozita "NËNTORI 1", Muzeu Historik, Tiranë.
- 1999 Ekspozita e artit kontemporan shqiptar "ALBANIA & ALBANIA" (Art & Maggio), Bari, Itali.
- 1999 Ekspozita "NËNTORI 2", Muzeu Historik, Tiranë.
- 1999 Ekspozita "FENSTER", Ferlach, Austri.
- 2000 Konkursi Ndërkombëtar "MARUBI 2000", G.K.A. Tiranë.
- 2000 Ekspozitë e fotografisë artistike, G.A. Shkodër.
- 2000 Ekspozitë pikturë, Klagenfurt, Austri.
- 2000 Ekspozita Ndërkombëtare "BALLKAN ART GENERATOR", Bruksel.
- 2000 Ekspozita "LOS PINTORES ALBANESES EN BARCELONA", Barcelonë, Spanjë.
- 2000 Skena dhe kostumet në komedinë: "ISHULLI I SHITENIT", Teatri "Migjeni", Shkodër.
- 2000 Piktor i kostumeve në filmin shqiptaro-kanadez "WOMEN WITHOUT WINGS".
- 2000 Ekspozita "NËNTORI 3", Muzeu Historik, Tiranë.
- 2001 Konkursi Ndërkombëtar "MARUBI 2001", G.K.A. Tiranë.
- 2001 Ekspozita "Albania ANTLITZ Austria", Ferlach, Austri.

2001 Ekspozita "NENTORI 4", Muzeu Historik, Tiranë.
2001 Ilustrimet dhe kopertina në librin për fëmijë "Dhelpra dhe ujku".
2001 Bashkëpunim si fotograf në revistën "XXL".
2002 Konkursi Ndërkombëtar "MARUBI 2002", G.K.A. Tiranë.
2002 Ekspozita "NENTORI 5", Muzeu Historik, Tiranë.
2002 Ekspozitë në "ART GALERI", Shkodër.
2003 Konkursi Ndërkombëtar "MARUBI 2003", G.K.A. Tiranë.
2003 Ekspozita "NENTORI 6", Muzeu Historik, Tiranë.
2003 Bashkëpunim si ilustrues me revistën kulturore "Mehr Licht".
2004 Konkursi Ndërkombëtar "MARUBI 2004", G.K.A. Tiranë.
2004 Biallja XI ndërkombëtare "Exhibition of Portrait Drawings and Graphics", Tuzla, Bosnjë-
Hercegovina.
2004 Konkursi Ndërkombëtar "Muslim Mulliqi", G.A. Prishtinë.
2004 Ekspozita "NENTORI 7", Muzeu Historik, Tiranë.
2005 Konkursin Ndërkombëtar "Marubi 2005", G.K.A. Tiranë.
2005 Ekspozita "NENTORI 8", Muzeu Historik, Tiranë
2005 Ekspozita "Fotografia Turistike Shqiptare", G.K.A. Tiranë.
2005 Ekspozita "CHANGE", Galeria e Vogël, Tiranë.
2005 Biallja Ndërkombëtare "TIRANA 3", Kompleksi "Goldi", Tiranë.
2006 Ekspozita "NENTORI 9", Muzeu Historik, Tiranë.
2006 Panairi "Libri '06", Q.N.K. Tiranë.
2007 Ekspozita "Fotografia Turistike Shqiptare", G.K.A. Tiranë.
2007 Ekspozita kombëtare "PaVarësia", G.K.A. Tiranë.
2007 Ekspozita "NENTORI 10", Muzeu Historik, Tiranë.
2008 Ekspozita "NENTORI 11", Muzeu Historik, Tiranë.
2009 Ekspozita "NENTORI 12", Muzeu Historik, Tiranë.
2010 Ekspozitë në Fenlach, Austri
2010 Konkursi Ndërkombëtar "ONUFRI '12", G.K.A. Tiranë.
2010 Ekspozita "NENTORI 13", G.K.A, Tiranë.
2011 Ekspozita "NENTORI 14", Muzeu Historik, Tiranë.
2012 Ekspozita ndërkombëtare e grafikës "I.C.O.N.", Zeta Galeri, Tiranë.
2012 Ekspozita "NENTORI 15", G.K.A, Tiranë.
2013 Ekspozita "NENTORI 16", G.K.A, Tiranë.
2013 Ekspozita "Hot Tabus", MIZA Galeri, Tiranë.
2014 Ekspozita "NENTORI 17", U.A. Galeri, Tiranë.
2015 Ekspozita "NENTORI 18", U.A. Galeri, Tiranë.
2016 Ekspozita "Tirana 1", Muzeu Historik, Tiranë.
2016 Ekspozita "NENTORI 19", U.A. Galeri, Tiranë.
2017 Ekspozita "NENTORI 20", Muzeu Historik, Tiranë
2018 Ekspozita "Tirana 2", Muzeu Historik, Tiranë
2018 Ekspozita "NENTORI 21", U.A. Galeri, Tiranë.

Aktiviteti kërkimor shkencor

Botimet dhe kumtesat

Mesi. A, shkrim kritik: *“Britma” e piktorit Gjovalin Paci*, Revista XXL, Nr 48, botim i Top Albania, Tiranë, Maj 2001.

Shkrimi kritik merr në analizë veprën e piktorit Gjovalin Paci, si një përpjekje e suksesshme e tij për të mbartur në të emocione konkrete të përjetimit real, por të transfiguruar në mënyrë organike në një lojë të dashur, me anë të stilit të tij unikal. Motivi dhe loja shkrihen në një dhe para nesh prezantohet një azhur i pasur ngjyror, i cili të kujton pasurinë ornamentale të veshjeve të traditës tonë popullore. Por veprat e Pacit, pas hedonistikës së tyre të pasur ornamentale dhe ngjyrore, fshehin një britmë therëse dhe intriguese si prej sirene. Konstelacionet ornamentale, të bukura si nëpërkat, mbartin së brendshmi frikën e ankthit ekzistencial të trupit të rrezikuar fizikisht e shpirtërisht, mbartin ngërçin e shpirtit që pjell britmën magjike të krijimit.

Mesi. A, artikull shkencor: *“Në atelienë e Art-Dizajnit, mes thurimës Tekne dhe Muzë”*, periodiku shkencor “Forum A+P” 5, botim i POLIS press, Tiranë, 2011.

Sipas babait të filozofisë, Platonit, Arti shihet si Tekne. Mitikisht zanafillat e artit janë teknet e lashta të metalpunimit dhe të endjes së pëlhurave që zotat i dhuruan njerëzve për të mbijetuar. Shkrimi paraqet përpjekjet e mia si pedagog i disiplinave të artit dhe dizajnit, për të edukuar studentët me shprehitë e duhura të nevojshme për profesionin e tyre si dizajner të ardhshëm. Në atelietë e edukimit pamor, aftësimi teknik dhe mjeshtëror është i domsdoshëm të ndërthuret me frymëzimin e lartë dhe sensin kreativ artistik, në mënyrë që të pregaditen artistë dizajner të aftë të përgjigjen kërkesave gjithnjë e më në rritje që shtron koha dhe tregu i emancipuar.

Mesi. A, dispencës për përdorim universitar: *“Vizatimi-gjurmë njerëzore në hapësirë”*, botim i POLIS press, Tiranë, 2013

Teksti didaktik në shërbim të formimit teorik të studentëve dizajner trajton zanafillën historike dhe mitike të lindjes së artit, që përkon me gjurmëlënien (vizatimin) mbi rrafshin në hapësirë, si nevojë e qënieve njerëzore për të komunikuar dhe ruajtur praninë e mungesës. Flitet për dy qasjet që e kanë shoqëruar dhe vazhdojnë ta shoqërojnë artin edhe sot: 1) qasja tradicionale, mimesisi ose imitimi i realitetit të jashtëm dhe 2) qasja moderne, interpretimi, zbulimi i realitetit të brendshëm. Gjithashtu përshkruhen veçoritë që e dallojnë vizatimin nga piktura dhe artet plastike, si dhe flitet për statusin e tij në kohëra si i varur dhe ndihmës i proceseve të shumta krijuese dhe prodhuese, apo sot i lartësuar si një medium i pamvarur artistik dhe me potencial të lartë shprehës.

Mesi. A, artikull studimor: *“Mbi dizajnin industrial dhe artet e aplikuara të periudhës komuniste në Shqipëri”*, Studime për Artin, botim i posacëm i QSA, Tiranë, 2014.

Dizajni industrial i periudhës së socializmit mban vulën e totalitarizmit. Ideja nomenale e të nesërme së lumtur zhvlerësoi të tashmen fenomenale dhe nevojën për sendet, objektet, konsumerizmin, kënaqësitë dhe lluksin. Regjimi komunist shqiptar pati në thelb të njëjtin pozicionim me etikën protestante të punës dhe jetesës. Tiparet e dizajnit modern si thjeshtësia,

ekonomizimi i shprehjes pamore dhe i kostos së prodhimit, standartizimi teknik dhe moduli u keqinterpretuan si uniformitet, standartizim ideologjik, varfëri dhe kursim ekstrem. Funkcionaliteti i diskutueshëm dhe diletantizmi i estetikës së paraqitjes, prodhimi i limituar dhe mungesat e shumta në treg, janë karakteristikat që shoqëruan dizajnin e produkteve industriale të përdorimit të përditshëm të asaj kohe.

Mesi. A, kumtesë shkencore: *“Ekonomia dhe Standartizimi i dizajnit komunist shqiptar si papadigmë e totalitaritetit” (mbi disa karakteristika të dizajnit të hapësirës së banueshme në periudhën e komunizmit në Shqipëri)*, Sesioni Shkencor me temë: “Arti si Sfidë”, organizuar nga Insituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit, QSA, Tiranë, dhjetor 2015.

Mënyrat, qëllimet dhe format sesi ç’ndërtohen dhe ndërtohen qytetet janë tregues sesi funksionon një shoqëri. Hapësira e banimit gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri u shndërruar në një “libër” të hapur ideologjik. Fenomeni i standartizimit të hapësirës së apartamenteve përfshiu uniformizimin e dizajnit të interiorit dhe të fasadave dhe quhej “tipizim”. Standardizimi është padyshim njëra nga format e dhunës psikologjike që ushtrohej mbi shtetasit nga pushtetit totalitar. Ky standardizim i mënyrës së të banuarit dhe të jetuarit synonte të ndikonte në procesin e standardizimit mendor, të automatizimit, të bindjes pa kushte, synonte të thyente çdo aftësi njerëzore për të gjeneruar ide dhe risi të reja, synonte për të gjymtuar çdo përpjekje të natyrshme për origjinalitet dhe liri të menduari në forma që nuk bënin pjesë në recetat e pushtetit.

Mesi. A, artikull shkencor: *“Communist Political History and its Traces in the Albanian Landscape of the Time”*, International Journal Anglisticum, Vol.6, No.4, ISSN 1857-8179. ISSN 1857-8187, ICV Impact Factor 6.88, Tetovë, Maqedoni, Prill 2017.

Ky tekst kërkimor trajton fenomenin e shënimit të territorit nga ndërveprimi i tij me njeriun jo si një individ i lirë, por si qenie sociale e komanduar politikisht. Në këtë rast vetë peisazhi merr karakterin e një hapësire relative, të ndryshueshme, ku shtresëzohen në kohë si në një palimpsest, gjurmët e historisë së pushtetit politik dhe ekonomik. Dizajnimi i peisazhit shqiptar gjatë 50 viteve të regjimit komunist, ishte ideologjik dhe mbante vulën e pushtetit politik e ekonomik të asaj kohe, ku nën udhëheqjen totalitare të një partie të vetme, me çdo gjë që u ndërtua në territor, u planifikua të dëshmohej ideja historiciste e “rrugës së vetme të suksesshme zgjedhur për përparim”. Teksti e analizon hapësirën si një fenomen antropologjik të shtresëzuar dhe peisazhin si një udhërrëfyes që na ndihmon të lexojmë fytyrën (vulën) e pushtetit politik të asaj kohe me anë të gjurmëve që ai ka lënë në të.

Mesi. A, artikull shkencor: *“Albanian landscape of the second half of the XIX”*, Balkan Journal of Interdisciplinary Research, Vol.3, No.1, ISSN 2410-759X ISSN 2411-9725, IIPCCG Graz, Austria, May 2017.

Shkrimi tenton të informojë mbi interesin që pati për të huajt Shqipëria e shek. XIX, jo në sensin politik por më shumë në atë kulturor dhe etnografik, vecanërisht për gjeografinë e peisazhit. Krijimtaria e piktorit anglez Edward Lear realizuar gjatë udhëtimit të tij në Shqipëri në vitin 1848 është një informacion sa artistik, po aq dhe real e dokumentues mbi atmosferën e kohës, peisazhin rural dhe atë të qëndrave të banuara, veshjet dhe arkitekturën shqiptare të asaj kohe.

Mesi. A, kumtesë shkencore: *“Traces of yesterday;s Communist impression in the Albanian landscape and the phenomena of today;s globalization exhibited on them”*(*communist archeology in contemporary Albanian art*), Second International Interdisciplinary Scientific Conference, organized in collaboration with Idea Scientific Journal, Mediterranean University of Albania, Center for Albanological Studies and College Iliria Kosovo, University of Helsinki Finland, Universitia degli Studi di Firenze, ISBN 978-9928-242-00-6 ISSN 2466-4308, Maj 2017.

Kjo kumtesë ka për qëllim të analizojë arkeologjinë urbane komuniste, me fokus trashëgiminë tonë industriale socialiste, fatin e përmendoreve e përkujtimeve të heroizmit të luftës për çlirim e punës për ndërtim, gjurmët e propagandës totalitare e kultit të individit shënjuar në territor, si dhe fenomenin e patologjisë së bunkerbetonizimit masiv të vendit gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri.

Fusha e studimit ku diskutimi operon në vazhdim është ajo e artit postmodern shqiptar, me përfaqësues tre artistë bashkëkohorë dhe një bashkëpunim në grup, të cilët me projektet e tyre artistike, ridimensionojnë trashëgiminë tonë të djeshme komuniste, duke ndërhyrë pamorisht në territor me propozime për të rikontekstualizuar apo rivitalizuar këto “trofe” të së kaluarës, gjithnjë sipas estetikës postmoderne të diskursit dhe logocentrizmit.

Mesi. A, kumtesë shkencore dhe botim proceeding: *“Albania’s initial orientation towards Western Modernity”*, (*first half of 20th century*), Second International Conference (ICES II-2017), Bialystok, organized by International Institute for Private-Commercial-and Competition Law (IIPCCCL) in partnership with University of Bialystok (Poland), Institut za naucna istrazivanja (Montenegro), Institute of History and Political Science of the University of Bialystok (Poland), Tirana Business University (Albania), University College Pjeter Budi of Pristina (Kosovo), ISBN 978-9928-214-67-6, Qershor 2017.

Në këtë kumtesë evidentohen dukuri të kulturës materiale shqiptare në periudhën e fillimshkullit të XX. Megjithëse rimodelimi i raportit të njeriut me natyrën nëpërmjet “revolucionit teknik” si esencë e modernitetit ndjehet vonë në Shqipëri, mbase si i fundit vend në Europën Juglindore apo Ballkan, me futjen e elementëve të parë kapitalist në prodhim dhe me dëshirat e politikës shqiptare të kohës për tu orientuar tërësisht drejt perëndimit, Shqipëria u transformua ndjeshëm. Dikotomia mes trashëgimisë orientale dhe evolucionit teknik oksidental të modernitetit është tepër e evidente në dukuritë e asaj kohe, përshfaqur veçanërisht në orientimin drejt modernizimit me tipare perëndimore të peisazhit të territorit, zhvillimit të qyteteve e planifikimit urban të tyre me skema racionale, ndërtimit të banesave, infrastrukturës rrugore, mënyrës së jetesës, veshjes, kulturës dhe artit.